

Nr. 1278 Data 25.05.2018

**“Trepça –Pjesa e administruar në Jug të
Mitrovices”**

**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe
deklarata mbi rentën e ngarkuar, paguar dhe
obligimin për pagesë për vitin që perfundon
më 31 dhjetor 2017**

(dhe raporti i auditorit të pavarur)

Përmbajtja**Faqe**

Raporti i auditorit të pavarur	
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	4
Deklarata mbi rentën minerare të ngarkuar, paguar dhe obligimin për pagesë	5
Shënimet shpjeguese	6 - 7

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për “Trepça –Pjesa e administruar në Jug të Mitrovicës”

Ne kemi audituar pasqyren e të ardhurave dhe deklaraten mbi rentën minerare të “Trepça –Pjesa e administruar në Jug të Mitrovicës” të cilat përfshijnë pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe deklaraten mbi rentën e ngarkuar, paguar dhe obligimin për pagesë më dhe për vitin që perfundon më 31 dhjetor 2017, si dhe një përmbledhje të parimeve bazë kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyres së të ardhurave dhe deklarates mbi rentën minerare dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 03 L -163 “Per Minierat dhe Minerale” dhe ligjit nr. 04 L-158 per ndryshimin dhe plotesimin e ligjit L-163 per Minierat dhe Minerale dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Menaxhmenti, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e ketyre deklaratave financiare pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë të shprehim një opinion mbi pasqyren e të ardhurave dhe deklaraten mbi rentën minerare. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të fitojmë siguri të arsyeshme që pasqyra e të ardhurave dhe deklarata mbi rentën minerare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të nevojshme për auditim, për vlerat dhe shpalosjet në pasqyren se të ardhurave dhe deklarates mbi rentën minerare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, këtu përfshihen dhe vlerësimi i rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive në pasqyren e të ardhurave dhe deklarates mbi rentën minerare, qofshin këto si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyres së të ardhurave dhe deklarates mbi rentën minerare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyres së të ardhurave dhe deklarates mbi rentën minerare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë, ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Mohimi i Opinionit

Ne u angazhuam të auditojmë pasqyrat financiare të Ndërmarrje shoqërore Trepça –Pjesa e administruar në Jug të Mitrovices, “Shoqërisë”, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017, dhe pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave, Pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat përcjellëse financiare të Shoqërisë. Për shkak të rëndësisë së çështjeve madhore të trajtuara në Bazat për Mohim të pjesës së opinionit tonë, ne nuk kemi qenë në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit për të siguruar një bazë për një opinion të auditimit mbi këto pasqyra financiare.

Bazat për Mohimin e Opinionit

Siç është shpalosur në shënimin 1 të pasqyrave financiare, këto pasqyra financiare prezantojnë vetëm pozicionin financiar të njësisë së Shoqërisë e cila administrohet në Jug të Mitrovicës dhe jo të Shoqërisë Trepça në tërësi. Këto pasqyra financiare janë të mangëta pasi nuk prezantojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë dhe të gjithë njësitëve të sajë, dhe si të tilla nuk mund të konsiderohen që janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe raportimit financiar në bazë të ligjit Ligji Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe të Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar të cilat janë të aplikueshme në Kosovë.

Siç është përcaktuar në ligjin për Trepçën Ligji Nr. 05/L -120 i cili ka hyrë në fuqi më 31 tetor 2016 Shoqëria Trepça është në proceset ristrukturimit dhe të kalimit nga Ndërmarrje Shoqërore nën administrim të Agjencionit Kosovë të Privatizimit në Shoqëri Aksionare ku 80% e aksioneve janë në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 20% në pronësi të punëtorëve të saj. Deri me datën e raportimit kërkesat që dalin nga ligji në lidhje me ristrukturimin dhe menaxhimin e shoqërisë nuk janë funksionalizuar. Statuti i shoqërisë aksionare nuk është hartuar nga bordi mbikëqyrës, Ministria përkatëse, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ende nuk ka ndërmarrë të gjitha veprimet juridike për regjistrimin e Trepça Sh.A. në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe deri me sot nuk janë themeluar dhe organizuar njësitë përkatëse që janë kërkesë ligjore. Për më tepër nuk ka ende një identifikim dhe vlerësim i pronave të shoqërisë dhe nuk është bërë vlerësimi i tyre siç edhe kërkohet në ligjin për Trepçën, po ashtu kërkesës ligjore që do duhet definuar se cilat nga pronat do mbesin pronësinë e shoqërisë dhe cilat nga pronat do mbesin në pronësi të Agjencionit Kosovë të Privatizimit nuk është bërë deri me datën e realizimit, të gjitha këto çështje kanë ndikime në pasqyrat financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2017.

Ne u emëruam si auditorë të Shoqërisë më datë 30 prill 2018 dhe kështu ne nuk kishim mundësi që të bëjmë vëzhgimin e numërimit fizik të stoqeve, parasë së gatshme, dhe mjeteve themelore në fillim dhe në fund të vitit. Ne nuk ishim të kënaqur me mjete alternative në lidhje me sasinë dhe vlerën e stoqeve, parasë së gatshme, dhe mjeteve themelore të mbajtura dhe të prezantuara në pasqyrat financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017 dhe 2016.

Siç është shpalosur në Shënimin 5 të pasqyrave financiare përcjellëse, më 31 Dhjetor 2017 përfshirë në totalin e Pronës, Impianteve dhe pajimeve të Shoqërisë vlera e tyre është 12,179,150 euro (31 dhjetor 2016; 12,646,035 euro). Pjesa dërmuese e Pronës, Impianteve dhe pajimeve të Shoqërisë janë shumë të vjetra dhe disa prej tyre nuk janë funksionale dhe për një kohë të gjatë nuk janë në përdorim dhe nuk është bërë ndonjë renovim apo përmirësim i jetëgjatësisë dhe funksionalitetit të tyre. Kompania nuk ka bërë rivlerësimin e pasurive themelore siç kërkohet për rastet të tilla nga standardet ndërkombëtare të raportimit financiar për të parë diferencën e vlerës së mjeteve themelore kontabël dhe vlerës së tyre të drejt të tregut. Për më tepër, duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban Shoqëria, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të Pronës, Impianteve dhe pajimeve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2017. Po ashtu Shoqëria nuk ka një metode konsistente në lidhje me kapitalizmin e shpenzimeve dhe zhvlerësimin e tyre. Për më tepër, regjistri kontabël i Pronës, Impianteve dhe pajimeve nuk barazon me totalin e pronës, impianteve dhe pajimeve në pasqyrën e pozicionit financiar për EUR 4,264,793.

Nga Shoqëria te gjitha shpenzimet për përgatitjen te minierave janë njohure direkt shpenzime ne pasqyrën e te ardhurave ne periudhën qe kane ndodhur, njohja, matja dhe prezantimit i tyre nuk është bere siç kërkohet me Standardet Ndërkombëtarë IAS 16 dhe IFRIC 20 qe te behet kapitalizimin i tyre ne pasuri dhe te behet zhvlerësimi i tyre ne periudhat përkatës.

Siç është shpalosur në shënimin 6 të pasqyrave, stoqet janë në vlerë 753,136 (31 dhjetor 2016: 1,164,258). Siç kërkohet nga SNK 2, Kompania nuk ka bërë kapitalizimin e shpenzimeve të shkaktuara për prodhimin e stoqeve në vlerën e këtyre stoqeve. Si rrjedhoje ne nuk ishim ne gjendje të përcaktojmë nëse do të kishte qenë i nevojshëm ndonjë rregullim ne vlerën e stoqeve apo te koston së prodhimeve të shitura.

Ne e kishim te pa mundur qe te kemi evidence te mjaftueshme te auditimit dhe te përshtatshëm ne lidhje me ekzistencën dhe tërësinë e balancave te llogarive te arketueshme me 31 dhjetor 2017 prej EUR 3,919,955 (31 dhjetor 2016: EUR 4,490,302), ishte e pa mundur te kemi verifikim nga palët e treta, për me tepër ne nuk ishim ne gjendje për te vlerësuar se a do duhej qe te kemi njohje te provizioneve në llogaritë e arkëtueshme dhe ne çfarë niveli si pasojë e mungesës së informacionit adekuat.

Siç është shpalosur ne shënimin 8, paraja dhe ekuivalentet e sajë janë ne vlere prej EUR 1,914,634 (31 dhjetor 2016: EUR 2,209,159). Kompania nuk e ka të njohur ne pasqyrat financiare te saj shumen e parasë se gatshme të bllokuar në llogarinë escrow të mbajtur në bankën NLB ne vlerë prej EUR 1,578,773.

Siç është shpalosur ne shënimin 10 te pasqyrave financiare, bilanci i te hyrave nga grandet e shtyra te Shoqërisë me 31 dhjetor 2017 arrin shumën prej 3,244,380 euro (31 Dhjetor 2016; 3,964,313 euro). Ne mungese te konfirmimeve nga palët e treta dhe duke pasur parasysh natyrën e shënimeve qe mban Shoqëria, ne nuk ishim ne gjendje te sigurohemi rreth vlefshmërisë dhe plotësisë së detyrimeve afatgjata te Shoqërisë me 31 dhjetor 2017. Si rrjedhoje ne nuk ishim ne gjendje te përcaktojmë nëse ndonjë rregullim do te kishte qenë i nevojshëm për te hyrat nga grandet, të njohura ne pasqyrën e te ardhurave (shpalosja 16).

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2017 ishin EUR 4,161,799 (2016: EUR 4,499,514), ne e kishim te pa mundur qe te kemi evidence të mjaftueshme të auditimit dhe të përshtatshme në lidhje me ekzistencën dhe tërësinë e balancave të llogarive të pagueshme më 31 dhjetor 2017, respektivisht 2016, ishte e pa mundur te kemi verifikim edhe nga palët e treta.

Shoqëria nuk ka njohur ne pasqyrat financiare të saj, detyrimet për rentën minerare të deklaruar ndër vite tek Komisioni për Miniera dhe Minerale i Kosovës sipas ligjit numër 03 L -163 “Për Minierat dhe Minerale” dhe ligjit nr. 04 L-158 per ndryshimin dhe plotesimin e ligjit L-163 per Minierat dhe Minerale. Në bazë të të dhënave të prezantuara nga Shoqëria vlera e rentës e pa regjistruar dhe prezantuar në pasqyrat financiare është EUR 6,580,678. Si rezultat i natyrës së regjistrimeve të mbajtura nga kompania dhe në pamundësi të marrjes së konfirmimeve nga pala përkatëse ne nuk ishim ne gjendje te përcaktojmë vlerën e saktë të korigjimit që do duhet bërë nga shoqëria në pasqyrat financiarë me 31 dhjetor 2017 dhe ne vitet paraprake përkatëse.


Si rezultat i çështjeve me larte dhe natyrës se regjistrave kontabël te mbajtur lëvizjet ne shpalosjen e kapitalit tek fitimet e mbajtura nuk barazojnë ne vijueshmëri nga viti paraprak për EUR 1,627,512.

Si rezultat i këtyre çështjeve, ne nuk ishim në gjendje për të përcaktuar nëse ndonjë nga rregullimet mund të ketë qenë mundur dhe të nevojshme në lidhje me stoqet e pa regjistruar, mjeteve themelore dhe parasë se gatshme të regjistruara ose të paregjistruara, si dhe llogaritë e arkëtueshme dhe te pagueshme, dhe për elementet që përbëjnë pasqyrën e të ardhurave për vitin 2017, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukset monetare. Për me tepër ne e kishim te pa mundur për te bere procedurat tona te rregullta te auditimit pasi mungojnë regjistrimet e rregullta kontabël për periudhat përkatëse, si pasoj informacion jo te sakta te dhënave te ofruara ne nuk mund te vlerësojmë se sa do te ishte efekti ne pasqyrat financiare qe përfundon me 31 dhjetor 2017.

Siç është shpalosur ne shënimin 17 te pasqyrave financiare përcjellëse, librat dhe regjistrimet tatimore te Shoqërisë nuk janë audituar nga Autoritetet tatimore për vitin qe përfundon me 31 dhjetor 2017. Si rrjedhoje te gjendjes te raportimit financiare dhe mbajtjes se librave te Shoqërisë e ne veçanti te pikave te përmendur me sipër ne bazën për mohim te opinionit dhe korigjimeve te mundshme si ne bilanc te gjendjes dhe pasqyrën e te ardhurave dhe diferencave te mundshme nga raportimet qe janë deklaruar ne administratën tatimore te Kosovës, detyrimet tatimore te Shoqërisë mund te kenë ndryshime. Provizionet për taksat shtese dhe gjobat, nëse ka ndonjë, nuk mund te përcaktohen me ndonjë saktësi te arsyeshme nivelin e tyre ne ketë faze.

Çështje tjera

Pasqyrat financiar te Shoqërisë për vitin financiare me 31 dhjetor 2016 janë te audituara nga një auditor tjetër dhe është dhënë mohim opinion me date 18 maj 2017


NDËRMARRJA SHËRBVESE
AUDIT GROUP
Audit Group Shpk_{SH.P}
Rr: Lidhja e Pejes nr. 269
Dardania, 10000 Prishtinë
Kosovë

Prishtinë, Kosovë
21 maj 2018

Verejtje: Ky raport eshte pergaditur per qellime te raportimit ne Komisionin e Pavarur per Miniera dhe Minerale dhe nuk eshte i dedikuar per perdorime tjera.

Trepça –Pjesa e administruar në Jug të Mitrovices**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017**
(vlerat në Euro)

Shënime	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2017	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016
Te hyrat		
Te hyrat nga shitja	16,003,378	14,671,045
Te hyrat tjera	323,131	389,599
Total	16,326,509	15,060,644
Shpenzimet		
Shpenzimet e personelit	(12,962,739)	(10,822,219)
Shpenzimet e materialit dhe lendes se pare	(3,680,969)	(4,470,612)
Shpenzimet e zhvleresimit	(777,411)	(835,214)
Shpenzimet tjera operative	(1,389,175)	(1,355,519)
Shpenzimet tjera afariste	-	(196,136)
Provizioni per llogari te arketueshme	-	(4,924)
Gjithsej shpenzimet	(18,810,294)	(17,684,624)
Te ardhurat financiare	3,741,392	3,333,522
Shpenzimet financiare	(70,413)	(59,034)
Shpenzimet neto financiare	3,670,979	3,274,488
Fitimi para tatimit	1,187,194	650,508
Shpenzimi i tatimit në fitim	(118,719)	-
Fitimi neto për vitin	1,068,475	650,508
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Totali i të hyrave gjithëpërfshirëse për vitin	1,068,475	650,508

Trepça –Pjesa e administruar në Jug të Mitrovices

Deklarata mbi rentën minerare të ngarkuar, të paguar dhe obligimin për pagesë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017

(vlerat në Euro)

Raporti për minierën me flotacion në Stantërg

Periudha	Sasia e mineralit të shfrytzuar në m3	Renta që duhet të paguar	Renta e paguar		Detyrimi per pagesë
			Shuma ne Euro	Data e pagesës	
TM1	31,306	220,220	-	-	220,220
TM2	32,291	180,923	-	-	180,923
TM3	32,038	201,984	-	-	201,984
TM4	29,722	232,070	-	-	232,070
Gjithsejt	125,357	835,197	-	-	835,197


Raporti për minierën me flotacion në Kishnicë dhe Artanë


Periudha	Sasia e mineralit të shfrytzuar në m3	Renta që duhet të paguar	Renta e paguar		Detyrimi per pagesë
			Shuma ne Euro	Data e pagesës	
TM1	12,460	84,704	-	-	84,704
TM2	17,761	103,890	-	-	103,890
TM3	16,100	85,369	-	-	85,369
TM4	13,516	65,626	-	-	65,626
Gjithsejt	59,837	339,589	-	-	339,589

Gjithsej raporti i përbashkët për minierat: Stantërg, Kishnicë dhe Artanë për vitin 2017

Periudha	Sasia e mineralit të shfrytzuar në m3	Renta që duhet të paguar	Renta e paguar		Detyrimi per pagesë
			Shuma ne Euro	Data e pageses	
TM1	43,766	304,924	-	-	304,924
TM2	50,052	284,813	-	-	284,813
TM3	48,138	287,353	-	-	287,353
TM4	43,238	297,696	-	-	297,696
Gjithsejt	185,194	1,174,786	-	-	1,174,786

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe deklarata mbi rentën minerare u autorizuan, aprovuan dhe u nënshkruan në emër të menaxhmentit me datë 21 maj 2018.


Miftar Hyseni
 Drejtor ekzekutiv



Trepça –Pjesa e administruar në Jug të Mitrovices

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017

(vlerat në Euro)

1. Informata të përgjithëshme

Trepça - Ndërmarrje nën Administrim të AKP-së është ndërmarrje shoqërore. Nga data 8 Nëntor 2011 Agjencia Kosovare e Privatizimit shërben si administratore e ndërmarrjes Trepça.

Ndërmarrja është themeluar me 3 Shkurt 2006 si Ndërmarrje shoqërore. Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes janë: prodhimi i makinave për miniere, prodhimi i akumulatorëve i stacioneve dhe baterive elektrike, riciklimi i mbeturinave dhe hedhurinave metalike, nxjerrja e mineraleve dhe metalit, prodhimi i metaleve të çmuara, tregtia me shumicë e metaleve dhe xeheve, etj.

Kompania është licencuar nga KPMM për aktivitetin minerar për mineralet metalike si me poshte:

-Miniera në Stanterg është me numer licence 1487/KPMM/2015

-Miniera në Artane është me numer licence 1488/KPMM/2015

Numri i punëtorëve më 31 Dhjetor 2017 është 1,337 (31 Dhjetor 2017: 1,392) punëtorë të rregullt.

2. Bazat e përgatitjes dhe politikat kontabël

Këto deklarata financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit sipas ligjit nr. 03 L -163 "Për Minerat dhe Mineralet" dhe ligjit nr. 04 L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit L-163 për Minerat dhe Mineralet. Vlerat financiare janë paraqitur në njësi monetare Euro. Këto pasqyra nuk përmbajnë tërësinë e aktivitetit të kompanisë por përfaqësojnë vetëm transaksionet dhe aktivitetin minerar të kompanisë sipas licencës nga KPMM.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

3.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Pasqyrat financiare janë përgatitur në Euro, e cila është edhe monedha funksionale e kompanisë.

3.5 Njohja e të hyrave

Të hyrat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën e arkëtueshme për mallrat dhe shërbimet e ofruara në rrjedhën normale të biznesit, pa përfshirë kthimet e konsumatorëve, zbritjet dhe taksat që kanë të bëjnë me shitjet.

Të hyrat nga shitja e mallrave njihen kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë të plotësuara:

- Kompania ka transferuar tek blerësi rreziqet dhe shpërblimet e rëndësishme të pronësisë së mallrave;
- Kompania nuk e ruan as përfshirjen e vazhdueshme menaxheriale në nivelin që zakonisht lidhet me pronësinë dhe as kontrollin efektiv mbi mallrat e shitura;
- Shuma e të hyrave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të rrjedhin te Kompania; dhe
- Shpenzimet e shkaktuara ose që do të shkaktohen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

3.6 Tatimi në fitim

Tatimi është paraqitur në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin tatimor të Kosovës aktualisht në fuqi, Ligji nr. 03/L-162 "Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave".

4. Ngjarjet pas datës raportuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonin shpallje në pasqyrat financiare të Kompanisë.



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Trepça – Ndërmarrje në Administrim të AKP-së
Trepça – Enterprise under PAK Administration



Adresa: Parku industrial Mitrovicë, tel. 028/538 050, 531 135, Fax 028/539 202 e-mail: contact@trepca-akp.com
Address: Mitrovica Industrial Park, tel. 028/538 050, 531 135, Fax 028/539 202 web: www.trepca-akp.com

Trepça- Ndërmarrje në Administrim të AKP-së

RAPORT I PUNËS VJETORE
Licencë shfrytëzimi
Viti 2017

Emri i ndërmarrjes:	Trepça-Ndërmarrje në Administrim të AKP-së
Nr. i regjistrimit:	70331094
Nr. i licencës:	1487/KPMM 2015
Pronari (Menaxheri):	Qazim Jashari
Lloji i Lëndës Minerale:	Xehe Pb dhe Zn
Nr. i biznesit:	70331094
Komuna:	Mitrovicë
Regjioni:	Mitrovicë

Datë: 08.03.2018

XEHETARIA-AKTIVITETI MINERAR

Ndërmarrja: Trepça- Ndërmarrje në Administrim të AKP-së

Miniera me flotacion „Trepça” Stantërg

Nr. i regjistrimit: 70331094

Nr. i licencës: 1487/KPMM 2015

Përshkrimi i punëve të kryera gjatë procesit të shfrytëzimit

Lloji i aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit
Zbulimi:	
Stivimi:	
Ngarkimi:	
Shpim Minimi:	
Transporti:	
Përpunimit (Seperimit, Pasurimit):	
Punët rreth largimit të ujërave:	
Ndryshime nga projekti i shfrytëzimit:	
Konfirmo se zona e licencës është e shënuar:	
Kontrollimet Sistematike Mjekësore:	
Trajnimet e punëtorëve:	
<i>Shto rend sipas nevojë:</i>	

Të dhëna mbi aksidentet gjatë zhvillimit të aktivitetit minerar

Natyra e lëndimit	Nr.	Përshkrim i shkurtër i aksidentit
Lëndime kolektive:		
Lëndime të Renda:	14	
Lëndime të lehta:	11	
<i>Shto rend sipas nevojë:</i>		

Statistikat e fuqisë punëtore të ndara në kategori

Kategoria	Nr.
Menaxhmenti:	
Staf i zyrës:	
Punëtor:	

Vozitës:	
<i>Shto rend sipas nevoje:</i>	

Statistikë e fuqisë punëtore të ndara sipas kualifikimit

Kualifikimet	Nr.
Lartë dhe superior:	
I mesëm:	
Të pa kualifikuar:	
<i>Shto rend sipas nevoje:</i>	

Raport rreth ndikimeve mjedisore

Lloji i ndotjes (ndikimit në ambient)	<i>Përshkrim i shkurtër</i>
Pluhuri:	
Zhurma:	
Rrjedha ujore:	
<i>Shto rend sipas nevoje</i>	

ARSYETIM


1. Gjeodetet janë të punësuar me kontratë të përhershme pune .
2. Kopjet e planit dhe fleteposedimet të pronës së trepçes janë marrur në kadastrë , koordinatat (X,Y,Z) nuk i kemi të konvertuara në kosovaref01.
3. Nuk kemi digjitalizim të hartave pasi që mungojnë mjetet për digjitalizim .
4. Nuk kemi digjitalizim.

STAN TËRG

19/03/2018

GJEODET:

1. Beqir SAHITI 

2. Sherif BEGU 

GJEODEZI

(Situacioni Gjeodezik)

Ndërmarrja:

Nr. i regjistrit:

Nr. i licencës:

Përmbajtja e raportit:

1. Licenca e Gjeodetit të Licencuar apo kompanisë Gjeodezike të licencuar (Kopje)
2. Shënimet origjinale të matjeve nga terreni (nr.y,x,h) në *xls format (letër dhe CD)
3. Situacioni i terrenit në letër dhe CD.
4. Situacioni i terrenit në formë digjitale (*dxf)
5. Raport mbi masat (e ekspluatara) të llogaritura nga situacioni i terrenit në formë digjitale.

Unë i poshtë nënshkruari deklaroj se të dhënat e paraqitura më lartë përputhen më realitetin dhe gjendjen momentale të minierës.

Gjeodeti:

Emri dhe Mbiemri:

Nënshkrimi:

Pronari i ndërmarrjes:

Emri dhe Mbiemri:

Nënshkrimi:



Koordinatat për zonen e shfrytëzimit

Nr.	X	Y
a	4756000	7492580
b	4756000	7495380
c	4754220	7495380
d	4754220	7492580

Koordinatat për zonen e zvogëluar e hulumtimeve

Nr.	X	Y
1	4759880	7491740
2	4754720	7497560
3	4753000	7495560
4	4753000	7494580
5	4754220	7493040
d	4754220	7492580
6	4754660	7492580
7	4756220	7490580
B	4758040	7489760

Koordinat për zonen e re të hulumtimit

Nr.	X	Y
A	4752500	7491580
B	4758040	7489760
7	4756220	7490580
6	4754660	7492580
D	4754220	7492580
5	4754220	7493040
4	4753000	7494580
3	4753000	7497560
2	4754720	7497560
1	4759880	7491740
C	4761540	7493580
D	4758040	7497580
E	4756320	7498300
F	4752500	7498300


Stan Tërg

19/03/2018


Gjeodet:

1. Beqir SAHITI


2. Sherif BEGU





Mine Stan Trg




Mine Stan Trg










1 : 25 000



1 : 25 000

FINANCA

1. DETAJET E NDËRRMARJES:					
Ndërrmarja:			NRB:	Nr.i Licencës	
Trepça –Ndërrmarje në Administrim të AKP-së			70331094	Nr.i aplikacionit	
Data e raportimit		Selia e Biznesit		Vendshfrytëzimi	Lloji i Mineralit
Data	Muaji	Viti	Mitrovicë	Miniera Santërg	Xehe Pb dhe Zn
08.	03	2018			
Numri i punëtorëve			Shuma e pagave mujore	Shuma e pagave vjetore	
706			619,126.47 €	7,804,532.17 €	
Aktiviteti primar i biznesit		Aktiviteti sekondar i biznesit		Aktivitetet tjera	
Ekspluatim dhe përpunimi – flotimi i xehes		- Prodhimi i sulfatit të Aluminit. - Prodhimi i Rimorkiove. - Pjesë të ndryshme makinerike.			
Nëse jeni duke ushtruar dy e më shumë aktivitete në biznesin tuaj, a mbani libra apo evidence të veçantë për punët apo aktivitetet minerare për të cilin jeni të licencuar në KPMM x Jo <input type="checkbox"/> Po					

*Plotësohet nga personi përgjegjës për financa

2. INVESTIMET KAPITALE GJATË VITIT 2017	
Investimet duhet të jenë të lidhura me aktivitetin minerar:	
Përshkrimi	Vlera
Hapja e vendëpunishtëve të reja në horizontin e –X- dhe XI	635,475.91 €
Riaftëzimi i punishtëve në horizontin -VII- dhe të -IX-	699,999.83 €

3. SHPENZIMET OPERATIVE GJATË VITIT 2017	
Shpenzimet duhet të jenë të lidhura me aktivitetin minerar	
Përshkrimi	Vlera
Shpenzimet Operative Materiale	2,029,664.18 €
Pagat e punëtorve	7,804,532.17 €

4. ÇMIMI NGA BERZA (LME) PËR METALIN (Pb)						
Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Çmimi në € për njësi (ton)	2105.11 €	2181.97 €	2131.64 €	2081.79 €	1930.33 €	1898.31 €
Muaji	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Çmimi në € për njësi (ton)	1969.62 €	1997.48 €	1995.50 €	2131.97 €	2100.06 €	2119.78 €
Vërejtje:						

5. ÇMIMI NGA BERZA (LME) PËR METALIN (Zn)						
Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
Çmimi në € për njësi (ton)	2553.98 €	2677.21 €	2603.93 €	2456.48 €	2344.89 €	2290.93 €
Muaji	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Çmimi në € për njësi (ton)	2420.34 €	2526.60 €	2618.50 €	2785.14 €	2757.71 €	2697.20 €
Vërejtje:						

6. RENTA MINERALE PER LËNDË MINERALE/METAL (Pb)			
Plotësohet nga ndërmarrja, të dhënat vjetore të ndara në tremujor për vitin përkatës. Paraqitini llojin e mineralit, çmimin e përdorur për kalkulim të rentës minerare dhe çmimin e berzës LME, pagesën e kryer rentës minerare për periudhën që raportoni.			
Periudha e raportimit	Sasia në (ton)	Shuma e rentës minerare për pagesë €	E paguar €
TM1	31,306.00 (t) Xehe * 3.44 % Pb * 2 138.66 € * 4.5%	103,643.07 €	0 €
TM2	32,290.50 (t) Xehe * 2.75 % Pb * 1,963.47 € * 4.5%	78,459.27 €	0 €
TM3	32,037.50 (t) Xehe * 3.09 % Pb * 1,987.69 € * 4.5%	88,547.90 €	0 €
TM4	29,722.00 (t) Xehe * 3.60 % Pb * 2,116.81 € * 4.5%	101,923.64 €	0 €
GJITHSEJ: TM1+TM+TM3+TM4	125,356.00 (t) Xehe Pb dhe Zn	372,573.88 €	0 €
7. RENTA MINERALE PER LËNDË MINERALE/METAL (Zn)			
Plotësohet nga ndërmarrja, të dhënat vjetore të ndara në tremujor për vitin përkatës. Paraqitini llojin e mineralit, çmimin e përdorur për kalkulim të rentës minerare dhe çmimin e berzës LME, pagesën e kryer rentës minerare për periudhën që raportoni.			
Periudha e raportimit	Sasia në ()	Shuma e rentës minerare për pagesë €	E paguar €
TM1	31,306.00 (t) Xehe * 3.17 % Zn * 2,610.44 € * 4.5%	116,577.05 €	0 €
TM2	32,290.50 (t) Xehe * 2.99 % Zn * 2,358.36 € * 4.5%	102,463.36 €	0 €
TM3	32,037.50 (t) Xehe * 3.12 % Zn * 2,521.89 € * 4.5%	113,436.25 €	0 €
TM4	29,722.00 (t) Xehe * 3.54 % Zn * 2,748.77 € * 4.5%	130,146.41 €	0 €
GJITHSEJ: TM1+TM+TM3+TM4	125,356.00 (t) Xehe Pb dhe Zn	462,623.07 €	0 €

*Të bashkëngjiten dëshmitë e raporteve tremujore (formularët e plotësuar, korrigjuar dhe te paguar) për vitin, nëse nuk i bashkëngjiten dëshmitë nuk do të pranohet ky formular i plotësuar. Nëse formulari nuk dorëzohet në kohë do të pasojnë gjokat administrative sipas Ligjit Nr. 03/L-163, si dhe ligji Nr. 04/L-158 neni 26.

*Shto tabelën 4 dhe 5, në varësi nga numri i lendeve minerale/metaleve.

* Në rast se Ndërmarrja nuk shfrytëzon lëndë minerale me rentë me % , të fshihet tab. 5,6 së bashku më sqarimet poshtë tabelës.

8. KONTRATAT DHE TRANSAKSIONET ME NDËRMARRJET TJERA			
Përshkrimi i Kontratës	Lloji i mineralit	Sasia (t)	Periudha
1. Mineco International Limited- London ECIV 7 DY	Koncentrat Pb	6,000.00	01.01.2017- 31.12.2017
2. KCM-AD 4009 Plovdiv Bullgari	Koncentrat Zn	9,000.00	01.01.2017- 31.12.2017
GJITHSEJ			

*Të plotësohet nga të gjitha ndërmarrjet që kanë Licenca dhe Leje Speciale.

*Shto tabelën 5, në varësi nga numri i lendeve minerale/metaleve.

9. TATIMET DHE TAKSAT ADMINISTRATIVE				
Tatimi i paguar gjatë vitit	TM1	TM2	TM3	TM4
Tatimi në Fitim:	0	0	0	0
TVSH:				
Taksa tjera (KPM):	0	0	0	0
TOTALI:				

10. PLANIFIKIMI I SHITJEVE TE MINERALIT TE CAKTUAR PËR VITIN(në vijim)			
Përshkrimi i Mineralit	Sasia në m³/ton	Çmimi shitës(Tregut)	Periudha
Koncentrat Pb	6,000.00 (ton)	1,834.32 \$/ton	01.01.2017 - 31.12.2017
Koncentrat Zn	9000.00 (ton)	854.95 \$/ton	01.01.2017 - 31.12.2017

VEREJTJE 1:Formulari duhet të plotësohet bazuar në Ligjit Nr. 03/L-163, te drejtat dhe obligimet e licencës dhe lejes, neni 34 . Ju lutem të bashkëngjiten dëshmitë e raporteve tremujore (formularët e plotësuar, korrigjuar dhe te paguar) për vitin 2014, nëse nuk i bashkëngjiten dëshmitë nuk do të pranohet ky formular i plotësuar. Nëse formulari nuk dorëzohet në kohë do të pasojnë gjokat administrative sipas Ligjit Nr. 03/L-163. Nëse keni me shume se një licencë apo leje, duhet të plotësohet formulari i veçantë për secilin numër të licencës apo lejes.



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Trepça – Ndërmarrje në Administrim të AKP-së
Trepça – Enterprise under PAK Administration



Adresa: Parku Industrial Mitrovicë, tel: 038 538 030, 538 135, Fax: 038 519 202 e-mail: contact@trepca-akp.com
Address: Mitrovica Industrial Park, tel: 038 538 030, 538 135 Fax: 038 519 202 web: www.trepca-akp.com

DEPARTAMENTI I MINIERAVE ME FLOTACION KISHNICE DHE ARTANE

Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP-së
Trepça - Enterprise under PAK Administration
Trepça - Produksion në Administrim të AKP-së
